



## STATUTI I SHOQËRISË AKSIONARE

"CASINO VLORA" SH. A

### KAPITULLI I

#### KRIJIMI, FORMA, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, EMËRTIMI DHE SELIA

##### Neni 1

##### Krijimi i shoqërisë

Shoqëria "Casino Vlora" sh.a. është themeluar si shoqëri aksionare (Më poshtë referuar si "Shoqëria") sipas ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i përditësuar.

##### Neni 2

##### Forma e shoqërisë

Shoqëria do të ketë formën e shoqërisë aksionare pa ofertë publike.

##### Neni 3

Emërtimi i shoqërisë është "Casino Vlora" sh.a.

Në të gjitha aktet dhe dokumentet e nxjerra nga shoqëria, emërtimi i shoqërisë do të ndiqet nga fjalët "Shoqëri Aksionare" ose inicialet sh.a.

##### Neni 4

##### Selia

Shoqëria e ka selinë në Vlorë në adresën: Bulevardi "Ismail Qemali", lagjia "Hajro Çakëri", rruga "Sulejman Delvina", pallati "Lazaj", hyrja veriore, kati i tretë.

Përveç vendndodhjes së selisë së saj, shoqëria ka të drejtën e krijimit dhe mbylljes së filialeve, agjencive dhe zyrave të përfaqësimit brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Selia mund të transferohet në çdo vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me një vendim të Asamblesë së aksionarëve.

##### Neni 5

## Objekti

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë "Casino Vlora" sh.a do të shtrihet në këto fusha veprimi:

Në fushën e "lojërave të fatit" shoqëria do të:

- organizojë lojëra të përcaktuara në ligj, ku pjesëmarrësve në këmbim të një shume të paguar u jepet mundësia e fitimit në para, sende apo të drejta të tjera, ku faktori fat ose ndonjë ngjarje tjetër e pasigurtë, ka ndikim të drejtpërdrejtë dhe është përcaktues si në fitimin, ashtu edhe në humbjen e pjesëmarrësve në secilën lojë;
- hapë kazino si zonë e veçantë për zhvillimin e lojërave të fatit, ku lojtarëve u ofrohet mundësia për të luajtur me mjetet e lojërave të fatit, si makina të tipit slot, të hedhin baste, baste në rulotë, video lotari ose makina elektronike, me shumë lojtarë, tryeza loje të quajtura "lojëra live", lojra online si dhe këmbim valutë në valutë ose mallra;
- hapë resort kazino si një kompleks kazinosh, i përbërë nga dy ose më shumë kazino, në hotele me të paktën 5 yje të integruara, të cilët kanë marrë Çertifikatën për këtë klasifikim nga institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare akredituese dhe infrastruktura të ndryshme ndihmëse (por pa u kufizuar vetëm në to);
- ushtrojë çdo veprimtari tjetër që lidhet me "lojërat e fatit" që është e lejueshme me ligjet që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Shoqëria do të pajiset me licencë për kategorinë "Kazino" sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 690, datë 02.09.2020 "Për përcaktimin e procedurave të zhvillimit të garës, kriteret shtesë për aplikantët që konkurrojnë për t'u pajisur me licencë për kategorinë "Kazino", procedura e shpalljes së fituesit, si dhe rastet e revokimit apo të pezullimit të kësaj licence.

## Neni 6

### Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me afat 30 vjet, duke filluar që nga data e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Në përputhje me këtë statut, shoqëria mund të mbyllë veprimtarinë e saj kur e sheh të arsyeshme, apo në rastet e parashikuara nga ligji.

## KAPITULLI II

### KAPITALI THEMELTAR; AKSIONET; AKSIONERËT

## Neni 7

### Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 3 500 000 (tre milion e pesëqind mijë) lekë.

Kapitali ndahet në 3500 (tre mijë e pesëqind) aksione me vlerë nominale 1000 (njëmijë) lekë për aksion, të numëruara nga 1 (një) deri në 1000 (njëmijë), të shlyera në masën 100% nga

aksionarët e saj. Ky kapital është i vlefshëm për regjistrimin e shoqërisë. Aksionet janë të pandashme.

Shoqëria ka si aksionarë të saj:

1. Asaf Barazani, shtetas i huaj, i biri i Avrahamit, lindur me 13.04.1957, në Afula dhe banues në Hollandë me adresë: Pallieterstraat 35 1183 LB Amstelveen, i cili zotëron 3150 (tremijë e njëqind e pesëdhjetë) aksione me vlerë nominale 1000 (njëmijë) lekë për aksion.
2. Franciska Ditte Hannah Brandjes Barazani, shtetase e huaj, e bija e Jo, lindur më 20.01.1959, në Den Helder dhe banues në Hollandë me adresë: Pallieterstraat 35 1183 LB Amstelveen, e cila zotëron 350 (treqind e pesëdhjetë) aksione me vlerë nominale 1000 (njëmijë) lekë për aksion.

## Neni 8

### Ndryshimi i kapitalit themeltar, zmadhimi i kapitalit

Kapitali themeltar zmadhohet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të shoqërisë, në përputhje me pikën I të nenit 145 të këtij ligji. Ndryshimet pasqyrohen në statut.

Aksionerët kanë të drejtë përparësie në nënshkrimin për zmadhimin e kapitalit.

Zmadhimi i kapitalit themeltar duhet të realizohet brenda pesë vjetëve nga data, në të cilën Asambleja e Përgjithshme ka vendosur apo ka dhënë autorizim për këtë zmadhim.

Për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë tregtare zbatohen nenet 168 deri në nenin 180 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

## Neni 9

### Zvogëlimi i kapitalit themeltar

Zvogëlimi i kapitalit themeltar vendoset nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me përcaktimet e pikës 1 të nenit 145 të këtij ligji, por nuk lejohet ky zvogëlim të bëhet nën kufirin e përcaktuar nga ligji.

Në mbledhjen e thirrur për këtë qëllim, dorëzohet raporti i arsyetuar i Administrimit, ku shpjegohen arsyet që bëjnë të mundur marrjen e vendimit për zvogëlimin.

Në të gjitha rastet zvogëlimi prek aksionerët në të njëjtën masë, në përpjesëtim me vlerën e aksioneve që zotërojnë.

Zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë bëhet në përputhje me nenet 181 deri në nenin 186 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

## Neni 10

### Shlyerja dhe verifikimi i kapitalit

Kapitali i secilit aksioner do të shlyhet në para. Secili aksioner vlerën e tij takuese në para, e ka të depozituar në llogarinë e tij bankare. Sapo shoqëria të krijohet dhe të hapë llogari bankare, brenda 10 ditëve nga data e hapjes së saj, secili ortak, përmes transfertës bankare do të realizojë shlyerjen e kapitalit aksioner.

## Neni 11

### Forma e aksioneve

Aksionet janë nominative. Pronësia e aksioneve pasqyrohet në librin e aksioneve, të mbajtur nga ana e shoqërisë ose nga ndërmjetësit financiarë.

Libri i aksioneve do të përmbajë në çdo kohë: numrin dhe kategorinë e aksioneve, datën e marrjes nga aksionari, emrin, mbiemrin dhe adresën e çdo aksionari si dhe vlerën nominale për çdo aksion të zotëruar.

Secili aksionar ka të drejtë të kërkojë me shkrim dhe të marrë një ekstrakt nga libri i aksionarëve, i cili vërtetohet me vulën e shoqërisë.

Secili aksionar ka të drejtë të verifikojë nëse emri i tij është në librin e aksionarëve dhe personi i cili mban librin është i detyruar t'i tregojë aksionarit me kërkesën e këtij të fundit, hyrjen përkatëse në libër.

## Neni 12

### Transferimi

Aksionet janë të pandashme. Çdo aksion jep të drejtën e një vote.

Aksionet e shoqërisë janë lirisht të transferueshme vetëm ndërmjet aksionarëve të shoqërisë. Në rastin kur një aksionar shet pjesën e tij të aksioneve, aksionarët e tjerë kanë të drejtën e blerjes së tyre proporcionalisht me shumën e aksioneve që zotërojnë. Aksionet e shoqërisë nuk janë lirisht të transferueshme tek të tretet. Ato mund t'u shiten të tretëve vetëm në rastin kur aksionet refuzohen të blihen nga aksionarë të tjerë të shoqërisë. Këtij kushti i nënshtrohen edhe aksionet që nënshkruhen në rastin e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë. Transferimi i aksioneve falas si rrjedhojë e trashëgimisë kryhet duke respektuar legjislacionin në fuqi.

Në rastet kur ndonjë nga aksionarët dëshiron të transferojë një pjesë ose të gjitha aksionet e tij, atëherë është i detyruar të njoftojë paraprakisht Këshillin Mbikëqyrës, duke i bërë të njohur edhe vlerën e aksioneve, me qëllim që aksionarët e tjerë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes.


Këshilli Mbikëqyrës është i detyruar që brenda dhjetë ditëve nga marrja e lajmërimit përkatës, të lajmërojë me shkrim të gjithë aksionarët e tjerë. Aksionarët e tjerë janë të detyruar që brenda njëzet ditëve të bëjnë të ditur me shkrim tek Këshilli Mbikëqyrës qëndrimin e tyre për ushtrimin e të drejtës së parablerjes.

Në rast se numri i aksionarëve, që interesohen për blerje aksionesh është më i madh se një, atëherë aksionet që ata do të marrin do të jet në përpjesëtim me numrin e aksioneve që ata zotërojnë.

Në rast se aksionarët nuk janë të interesuar për blerjen e aksioneve, atëherë aksionet mund t'i transferohen një t treti, por me kusht që transferimi i pronësisë mbi aksionet të miratohet paraprakisht prej shoqërisë sipas rregullave të përcaktuara të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Çdo transferim aksionesh që bëhet në kundërshtim me këtë ligj është i pavlefshëm dhe nuk sjell rezultat t ligjshëm si për aksionarët ashtu edhe për shoqërinë.

## Neni 13



4

## Aksionarët

Aksionarët e shoqërisë janë persona fizikë që kanë vënë në zotërim aksione të shoqërisë me të gjitha mënyrat e parashikuara nga ligji dhe nga ky statut. Zotërimi i aksioneve të shoqërisë u jep atyre të drejtën të marrin pjesë në Asamble dhe në votim në përpjesëtim me aksionet që zotërojnë.

Aksionarët kanë të drejtën e votës dhe të përfaqësimit në Asamblenë e aksionarëve me kushtet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi dhe ky statut.

Votat që zotërojnë aksionarët janë proporcionale me përqindjet e aksioneve që zotërojnë.

Çdo aksionar i shoqërisë ka të drejtën e pjesëmarrjes në fitimet e shpërndashme të shoqërisë në përputhje me aksionet e tij sipas vlerës nominale të zotëruar prej tij në kapitalin e shoqërisë.

Çdo aksionar ka të drejtë të marrë, kur është rasti, një tepricë nga likuidimi i kapitalit në përpjesëtim me vlerën e aksioneve që zotëron.

Aksionarët e shoqërisë janë vet përgjegjës për detyrimet dhe për humbjet e shoqërisë, deri në kufirin e vlerës nominale të aksioneve që zotërojnë. Përgjegjësia tej këtij kufiri është e ndaluar.

Të drejtat dhe detyrimet e përmendura më sipër ndjekin aksionin në çfarëdo forme që ai të tjetërsohet tek të tretët.

Aksionarë të Shoqërisë janë:

1. Asaf Barazani, shtetas i huaj, i biri i Avrahamit, lindur me 13.04.1957, në Den Helder dhe banues në Hollandë me adresë: Pallieterstraat 35 1183 LB Amstelveen, i cili zotëron 3150 (tremijë e njëqind e pesëdhjetë) aksione me vlere nominale 1000 (njëmijë) lekë për aksion;
2. Franciska Ditte Hannah Brandjes Barazani, shtetase e huaj, e bija e Jo, lindur më 20.01.1959, në Den Helder dhe banues në Hollandë me adresë: Pallieterstraat 35 1183 LB Amstelveen, e cila zotëron 350 (treqind e pesëdhjetë) aksione me vlere nominale 1000 (njëmijë) lekë për aksion;

## KAPITULLI IV

### ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

1. Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve
2. Këshilli Mbikqyrës.
3. Administratorët.

### ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONERËVE

#### Neni 14

#### Mbledhja e përgjithshme e aksionarëve



Organi vendimmarrës i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve, e cila përbëhet nga te gjithë aksionarët.

Mbledhjet mbahen ne selinë e shoqërisë, apo edhe në një vend tjetër, i cili u bëhet i ditur paraprakisht aksionarëve.

### **Neni 15**

#### **Thirrja e mbledhjes së asamblesë**

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve thirret nga Administratorët. Në mungese ajo mund të thirret edhe nga:

- ekspertët kontabël të autorizuar;
- subjektet e parashikuara sipas nenit 136 të ligjit 9901, datë 14.04.2008 i përditësuar.

Thirrja e Mbledhjeve të Asamblesë së Aksionarëve bëhet nëpërmjet njoftimit me letër rekomande, mesazh elektronik, ose nëpërmjet lajmërimit në dy gazeta të autorizuar. Njoftimi për mbledhjen duhet të bëhet 21 (njëzet e një) ditë përpara datës së caktuar për mbajtjen e saj. Njoftimi duhet te përmbajë: emrin e shoqërisë, ditën, orën, vendin ku do të mbahet mbledhja; përcaktimin e natyrës së saj (e zakonshme, e jashtëzakonshme); si dhe rendin e ditës; një sqarim te hollësishëm të procedurave që duhet të ndiqen nga aksionarët, për të marrë pjesë dhe votuar në asamble. Mënyra e thirrjes së Asamblesë së përgjithshme do të jete në përputhje me nenin 137 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Çdo mbledhje asambleje që thirret në mënyrë të parregullt mund të anulohet, megjithatë veprimi i anulimit nuk pranohet, kur të gjithë aksionarët janë prezent apo të përfaqësuar me prokurë.

### **Neni 16**

#### **Drejtimi i mbledhjes së asamblesë**

Mbledhjet e Asamblesë se Aksionarëve drejtohen nga Kryetari i Këshillit Mbikqyrës. Në mungesë të tij, këto mbledhje mund t'i drejtojë edhe një aksionar i emëruar nga Mbledhja e Aksionarëve.

Mbledhja e Asamblesë së Aksionarëve cakton një sekretar, i cili mund të jetë ose jo aksionar.

Aksionarët mund të përfaqësohen n Mbledhjen e Asamblesë së Aksionarëve, nga një aksionar tjetër apo bashkëshorti, që duhet t jenë të pajisur me prokurë.

Drejtuesi i Mbledhjes ka kompetencë të plotë të verifikojë prokurat dhe rregullsinë e tyre, arritjen e shumicës së kërkuar, me qëllim që vendimet e marra të jenë të vlefshme. Pas kësaj, drejtuesi i mbledhjes vendos zhvillimin e mbledhjes. Drejtuesi i mbledhjes ka të drejtë gjithashtu t drejtojë diskutimet dhe procedurën e votimit.

Proces - verbalet e mbledhjes së Asamblesë nënshkruhen rregullisht nga Drejtuesi i mbledhjes dhe sekretari.

### **Neni 17**

**Asambleja e përgjithshme**



Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve, mbahet të paktën një herë në vit, brenda gjashtë muajsh nga fundi i vitit financiar, me qëllim që të diskutohen, shqyrtohen dhe miratohen raportet financiare të vitit të kaluar.

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve konsiderohet e vlefshme në mbledhjen e saj të parë, nëse marrin pjesë Aksionarët, të pranishëm apo të përfaqësuar, që zotërojnë më shumë se 30 % të aksioneve me të drejtë vote. Në rast se nuk arrihet shumica e kërkuar më sipër, mbahet një mbledhje e dytë, pa u kërkuar ndonjë kuorum.

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve merr vendim me shumicën e votave që zotërojnë aksionarët e pranishëm apo të përfaqësuar.

Duke filluar nga momenti i lajmërimit të mbledhjes së Asamblesë së Zakonshme vjetore, çdo aksionar ose përfaqësuesi i tij, që do ta përfaqësojë në asamble ka të drejtë të informohet për të gjitha çështjet që parashikohen në nenin 135 të Ligjit nr. 9901, datë 14. 04. 2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe sidomos për:

- përcaktimin e politikave tregtare;
- ndryshime të statutit;
- emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të anëtarëve të këshillit mbikqyrës;
- emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të Ekspertëve kontabël të Autorizuar;
- regjistrimin, bilancin vjetor;
- zmadhimin apo zvogëlimin e kapitalit themeltar;
- raportet e Këshillit Mbikqyrës dhe të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar;
- shumën e shpërblimit të caktuar për personat e mësipërm.

## **KËSHILLI MBIKQYRËS DHE ADMINISTRATORI**

### **SISTEMI ME DY NIVELE**


#### **Neni 18**

#### **Të drejtat dhe detyrimet**

Këshilli Mbikqyrës ka këto të drejta dhe përgjegjësi për të gjitha funksionet e përcaktuara në pikat 1 shkronja a, b, ç, d, e, f dhe 2 të nenit 154 të këtij ligji dhe pikërisht:

- të japë direktiva për administratorët për zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- t'i kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e këtyre politikave nga ana e administratorëve;
- të thërrasë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme;
- të kujdeset që shoqëria të zbatojë ligjet dhe standardet e kontabilitetit;
- të sigurojë që pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit dhe publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga administratori. Të sigurojë që auditimi të kryhet një herë në vit dhe raporti i auditimit drejtuar asamblesë, t'u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të këshillit të administratorëve.
- të emëroj dhe shkarkojë administratorët.

Dhe të tjera detyrime e përgjegjësi që burojnë nga ligji i mësipërm.



## Neni 19

### Numëri, emërimi dhe përbërja e Këshillit Mbikqyrës

Këshilli Mbikqyrës përbëhet nga tre anëtar.

Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës zgjidhen nga asambleja e përgjithshme me shumicën e kërkuar sipas pikës 2 të nenit 155 të këtij ligji, për një periudhë tre vjet, me të drejtë rizgjedhje.

Anëtar të Këshillit Mbikqyrës janë:

1. Klajdi Mone, (Kryetar) shtetas shqiptar, i biri i Mihalit, lindur më 29.11.1978 në Vlorë dhe banues në Vlorë me adresë: lagja "Isa Boletini", pallati 10 katësh pranë ish mjeksorës, hyrja I, ap. 30.
2. Asaf Barazani, (anëtar) shtetas i huaj, i biri i Avrahamit, lindur më 13.04.1957, në Den Helder dhe banues në Hollandë me adresë: Pallieterstraat 35 1183 LB Amstelveen, i cili zotëron 90% të aksioneve të shoqërisë "Casino Vlora" sh.a.
3. Franciska Ditte Hannah Brandjes Barazani, (anëtare) shtetase e huaj, e bija e Jo, lindur më 20.01.1959, në Den Helder dhe banues në Hollandë me adresë: Pallieterstraat 35 1183 LB Amstelveen, e cila zotëron 10% të aksioneve të shoqërisë "Casino Vlora" sh.a.

## Neni 20

### Zgjedhshmëria e kufizuar, shkarkimi

Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës mund të zgjidhen nga radhët e aksionarëve dhe punëmarrësve të shoqërisë tregtare, si dhe nga radhët e individëve të tjerë jashtë shoqërisë.

Një individ nuk mund të zgjidhet si anëtar i Këshillit Mbikqyrës nëse ai njëkohësisht është:

- anëtar i një këshilli mbikëqyrës në dy shoqëri të tjera, të regjistruara në Republikën e Shqipërisë;
- është administrator i një shoqërie mëmë ose i një shoqërie të kontrolluar të shoqërisë;
- është administrator i një shoqërie tjetër, e cila ka si administrator ose anëtar të këshillit të administrimit, një anëtar të Këshillit Mbikqyrës apo të këshillit mbikëqyrës të shoqërisë së parë.

Çdo emërim i bërë në kundërshtim me pikën dy të këtij neni, është absolutisht i pavlefshëm. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë, në çdo kohë, një anëtar të Këshillit Mbikqyrës me shumicë të thjeshtë votash.

## Neni 21

### Shpërblimi

Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës mund të përfitojnë pagën bazë e shpërblime shtesë, përfshirë këtu pjesë nga fitimi i shoqërisë apo të drejta aksioni mbi aksionet e shoqërisë. Paga e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës mund të shtohet me shpërblime shtesë. Skema e këtyre shpërblimeve hartohet nga Këshilli Administrimit dhe miratohet nga Asambleja e Përgjithshme.

## Neni 22

### Rregulloret, kryetari dhe komitetet e posaçme

Këshilli Mbikqyrës mund të përcaktojë rregullore për procedurën e funksionimit të këshillit si dhe të marrjes së vendimeve.

Këshilli Mbikqyrës duhet të zgjedhë kryetarin dhe nënkryetarin e tij në përputhje me dispozitat e statutit. Një administrator nuk mund të zgjidhet kryetar i Këshillit Mbikqyrës.

Mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës regjistrohen në një procesverbal i cili nënshkruhet nga kryetari. Këshilli Mbikqyrës mund të krijojë komitete të posaçme, të përbërë nga anëtarët e vetë, për të përgatitur mbledhjet apo për të mbikëqyrur zbatimin e vendimeve të këshillit, sidomos ato të lidhura me veprimtarinë e administratorëve, shpërblimin e tyre, apo auditimin e librave të regjistrimeve kontabël.

Komiteti duhet të përbëhet nga anëtarë të pavarur që nuk janë administrator.

## Neni 23

### Marrja e vendimeve

Vendimet e Këshillit Mbikqyrës vlerësohen të vlefshme, nëse në procesin e vendimmarrjes janë të pranishëm më shumë se një e dyta e anëtarëve.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe kur për një çështje ka barazim votash, vota e kryetarit mbizotëron.

Vendimet e Këshillit Mbikqyrës mund të merren sipas përcaktimit në statut apo rregulloreve të këshillit, duke shprehur votën me shkresë, me telefon apo me mjete të tjera të komunikimit elektronik.

## Neni 24

### Detyrimet e besnikërisë dhe përgjegjësia

Përveç sa parashikohet në nenet 14, 15, 16, 17 dhe 18 të këtij ligji për detyrimin e besnikërisë, administratorët dhe anëtarët e Këshillit Mbikqyrës detyrohen:

- të ushtrojnë kompetencat, që u njihen në ligj ose në statut, vetëm arritjen e qëllimeve, të përcaktuara në këto dispozita;
- të vlerësojnë në mënyrë të përshtatshme çështjet, për të cilat merren vendim;
- të parandalojnë dhe të mënjanojnë rastet e konfliktit, të pranishme apo të mundshme, të interesave personale me ato të shoqërisë;
- të garantojnë miratimin e marrëveshjeve, sipas pikës 3 të nenit 13 të këtij ligji;
- të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratorët dhe anëtarët e Këshillit Mbikqyrës përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim apo mosveprim, gjatë kryerjes së detyrave të tyre.

Administratorët apo anëtarët e këshillit të drejtimit, që veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standardet e kujdesit, të përmendura në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, janë të detyruar t'i shpërblejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga shkeljet.

N mënyre të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratorët dhe anëtarët e Këshillit Mbikqyrës janë të detyruar t'i shpërblejnë shoqërisë dëmet e shkaktuara nëse në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryejnë veprimet e mëposhtme :

- u kthejnë aksionarëve kontributet;
- u paguajnë aksionarëve interesa apo dividende ;
- nënshkruajnë, blejnë, pranojnë si garanci apo anulojnë aksionet e shoqërisë ;
- emetojnë aksione përpara kalimit të kontributit në natyrë apo shlyerjes së vlerës nominale ose me çmim më të lartë;
- shpërndajnë aktivet e shoqërisë;
- lejojnë që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare kur në bazë të gjendjes financiare, duhej të ishte parashikuar se shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- kryejnë pagesa në favor të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës apo administratorëve ;
- japin kredi.

## Neni 25

### Përgjegjësia solidare

Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës dhe administratorët përgjigjen në mënyre solidare për vërtetësinë e të gjitha pasqyrave financiare, të publikimeve të detyrueshme dhe informacioneve të tjera kryesore të veprimtarisë së organizimit të shoqërisë, si ato vijuese, por pa u kufizuar në to, informacionin për sistemin e menaxhimit të riskut të shoqërisë, prospektet e veprimtarisë, planet e investimeve burimet teknike, etj.

## Neni 26

### Administratori

Këshilli Mbikqyrës emëron një ose me shumë persona fizik si administrator të shoqërisë, per një afat të pacaktuar në statut, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se tre vjet.

Administratorët janë të rizgjedhshëm.

Administratori i një shoqërie mëmë nuk mund të zgjidhet si administrator i një shoqërie të kontrolluar dhe anasjelltas. Administratori i një shoqërie mëmë nuk mund të jetë kryetar i Këshillit Mbikqyrës të një shoqërie të kontrolluar dhe administratori i një shoqërie të kontrolluar nuk mund të jetë kryetar i Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë mëmë. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është absolutisht i pavlefshëm .

Administratorët kanë të drejtë dhe detyrohen:

- të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
- të përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- të kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

- të përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilët ja paraqesin Këshillit Mbikqyrës për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, për t'u paraqitur më pas për miratim nga asambleja e përgjithshme;
- të krijojnë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë;
- të kryejnë regjistrimet dhe publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë sipas parashikimeve të këtij ligji apo ligjeve të tjera;
- të raportojnë përpara Këshillit Mbikqyrës për zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve me rëndësi të veçanta, për veprimtarinë e shoqërisë.


Detyrat që i cakton ligji Këshillit Mbikqyrës, nuk mund t'u delegohen administratorëve.

Nëse shoqëria emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë shoqërinë në mënyrë të përbashkët. Këshilli Mbikqyrës mund t'i shkarkojë administratoret në çdo kohë.

Administratore e shoqërisë për një periudhë 6 mujore emërohet:

1. Znj. Kejsi Bleta, shtetase shqiptare, e bija e Arbenit, lindur më 13.07.1997, lindur në Tiranë dhe banuese në Vlorë me adresë: lagjia "28 Nëntori", pallati nr. 6 përballë Kopshtit nr. 10, kati 6, ap. 12.

Kejsi Bleta



**Neni 27**

**Kontrolli i shoqërisë**

Kontrolli i shoqërisë ushtrohet nga një ekspert kontabël i regjistruar (auditues ligjor). Ekspert kontabël (auditues ligjor) emërohet për një periudhë 1 vjeçare shoqëria "KEI-AL AUDITNG" shpk me nr. NIPT: L37023201C me adresë lagjia "29 Nëntori", pallati 455, ap. 3, Vlorë.

## **KAPI TULLI V**

### **LLOGARITË, VITI FINANCIAR, INVENTARI**

**Neni 28**

Shoqëria mban në zyrat e saj librat e përcaktuar nga ligji, ku mbahen llogaritë vjetore, tabelat financiare vjetore, bilancet ekonomike vjetore, raportet ekonomike vjetore, në të cilat duhet të përfshihen dhe çdo kërkesë tjetër ligjore.



**Neni 29**

Viti financiar ka kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) muaj, duke filluar nga 1 Janari e deri më 31 Dhjetor të çdo viti.

**Neni 30**

**Rezervat e domosdoshme**

Kapitali rezervë, i domosdoshëm krijohet nga mbajtja e të paktën një shume prej 1/20 të fitimeve neto të shoqërisë, pasi janë zbritur më parë humbjet e mundshme të viteve të kaluara.

Kjo procedurë pushon së qeni e detyrueshme kur shuma e kapitalit të rezervuar arrin masën e 1/10 të kapitalit të shoqërisë.

#### **Neni 31**

##### **Ndarja e fitimeve**

Fitimet, që do tëë ndahen, përbëjnë fitimet e vitit financiar, mbasi të jenë zbritur rezervat dhe humbjet e mundshme të viteve më parë, sipas nenit të mësipërm.

#### **Neni 32**

##### **Përcaktimi i dividendëve**

Mbas miratimit të pasqyrave financiare të vitit paardhës dhe regjistrimin e shumës që do të ndahet, Asambleja vendos për shumën që do të ndahet në formën e dividendëve, në bazë të kapitalit aksionar.

### **KAPITULL IV**

#### **PRISHJA E SHOQERISË DHE LIKUIDIMI**

#### **Neni 33**

Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj.

Likuidimi i shoqërisë bëhet në bazë të dispozitave të përcaktuara nga nenet 187 deri 205 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008.

Në fazën e likuidimit, në emërtimin e shoqërisë do të përfshihet edhe shprehja "në likuidim e sipër". Ky tregues dhe emri i likuidatorit shënohen në të gjitha veprimet dhe dokumentet që lëshohen nga shoqëria tek të tretët.

#### **DISPOZITA TË FUNDIT**

#### **Neni 34**

Shoqëria ka vulën e saj, ku shkruhet emri i shoqërisë, sipas kërkesave ligjore.

Për ato që nuk janë shprehur në këtë Statut, do të bëhet referim në dispozitat e ligjit në fuqi. Ky Statut hartohet në 4 (katër) kopje origjinale me fuqi të njëjtë juridike.

Vlorë më, 21.06.2021

#### **AKSIONARËT E SHOQËRISË**

**Asaf BARAZANI**

Përfaqësuar me prokurë të posaçme

**Av. Klajdi MONE**

**Franciska Ditte Hannah Brandjes BARAZANI**

Përfaqësuar me prokurë të posaçme

**Av. Klajdi MONE**

12